

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

KOMISIONIT TË PAVARUR TË MEDIAVE (KPM)

dhe

ORGANIZATAVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA (OPAK):

1. HANDIKOS
2. SHOQATA E TË VERBËRVE TË KOSOVËS (SHVK)
3. SHOQATA KOSOVARE E TË SHURDHËRVE (SHKSH)
4. DOWN SYNDROME KOSOVA
5. FORUMI KOSOVAR I AFTËSISË TË KUFIZUAR

NENI 1 QËLLIMI

1. Përmes këtij memorandumi përcaktohet korniza e bashkëpunimit në mes të Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK) dhe Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), më poshtë të referuara si 'Palët', në funksion të zbatimit të obligimeve ligjore sipas fushave dhe legjislacionit përkatës.
2. Qëllimi i këtij memorandumi është bashkëpunimi ndërmjet Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Komisionit të Pavarur të Mediave, me qëllim të ngritjes së ndërgjegjësimit të medimeve audio vizuale në Kosovë, lidhur me terminologjinë e saktë për personat me aftësi të kufizuara. Synimi i këtij memorandum është parandalimi i terminologjisë të gabuara gjatë transmetimeve nga mediumet publike.

NENI 2
FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

1. Palët bien dakord që të ndërmarrin aktivitetet e mëposhtme:
 - 1.1. Organizatat e personave me aftësi të kufizuara, do të përgatisin një broshurë me terminologji adekuate për personat me aftësi të kufizuara dhe të njëjtën do ta përcjellin tek KPM për publikim.
 - 1.2. Organizatat e personave me aftësi të kufizuara do të dërgojnë në KPM ankesa për të gjitha rastet kur transmetuesit audio vizuel bëjnë shkelje në përdorimin e terminologjisë në kundërshtim me broshurën nga paragrafi 1 i këtij neni.
 - 1.3. Komisioni i Pavarur i Mediave obligohet do të shpërndajë tek redaksitë Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale, broshurën me terminologjinë adekuate për personat me aftësi të kufizuara, Shtojca 1 e këtij memorandum.
 - 1.4. Komisioni i Pavarur i Mediave do të rrisë përpjekjet në ndërgjegjësimin e mediave audiovizuale lidhur me terminologjinë adekuate për personat me aftësi të kufizuara.

NENI 3
KOMUNIKIMI MES PALËVE

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë informacionet e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të bëhet me shkrim dhe sipas nevojës do të mbahen takime bilaterale.
2. Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për përcjelljen e zbatimit konkret të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
3. Personat e kontaktit nga të dyja Palët do të jenë të disponueshëm për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve me Palën tjetër.

NENI 4
RISHIKIMI DHE AMANDAMENTIMI

Ky Memorandum mund të ri-shqyrtohet çdo vit dhe mund të ndryshohet apo plotësohet sipas një marrëveshje me shkrim në mes Palëve. Çdo aspekt tjetër, që nuk është përmendur në këtë memorandum, për të cilin Palët pajtohen shprehimisht me shkrim apo ne heshtje të bashkëpunojnë në të ardhmen, bëhet pjesë e integruar e këtij memorandum.

NENI 5
RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT

Asnjëra nga Palët nuk do të zbulojë ose nuk do të shpërndajë informacion konfidencial që i ofrohet nga Pala tjetër gjatë zhvillimit të aktiviteteve brenda fushave të përcaktuara me këtë marrëveshje, ndaj një Pale të tretë, përveç rasteve kur kërkohet dhe në masën e autorizuar me shkrim nga Pala tjetër ose kur parashikohet me dispozita ligjore.

NENI 6
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Në çdo rast të mosmarrëveshjeve, interpretimeve apo pikëpamjeve të ndryshme ndërmjet palëve, do të zhvillohen përpjekjet për arritjen e pajtimit të ndërsjellë, përmes bisedimeve.
2. Ndërprerja në mënyrë të njëanshme e këtij Memorandumi mund të bëhet në çdo kohë, nga KPM dhe OPAK, por duke lajmëruar me shkrim tridhjetë (30) ditë më parë Palën tjetër.

NENI 7
HYRJA NË FUQI

1. Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët dhe do të jetë i vlefshëm deri në momentin kur Palët të bien dakord për përfundimin e tij.
2. Me pajtim të plotë, palët nënshkruese, përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar, nënshkruajnë këtë Memorandum.

Nënshkruar në 6 (gjashtë) kopje identike, nga 1 (një) kopje për secilën nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE


Xhevat Latifi, Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave




Afrim Maliqi

HANDIKOS




Enver Kurtalani

SHKSH



Daut Tishuki

SHVK



Sebahate Beqiri

Down Syndrome Kosova



Bujar Kadriu

Forumi Kosovare i Aftësisë të Kufizuar

Nënshkruar në Prishtinë me datë

30 / 05 / 2022

Shtojcë 1.

Shtojcë e këtij memorandum janë terminologjitë e sakta, për personat me aftësi të kufizuara.

Termi i përgjithshëm
duhur

Person me aftësi të kufizuar

**Termet e përgjithshmetë
gabuar**

Person me nevoja të veçanta/ të
posaçme
Person me të meta
Invalid
Hendikep

Termet specifike të duhura

I/E Verbër
Person me dëmtim në të parë

I/E Shurdhër Person
gjysmë i/e shurdhër

Trupshkurtër

Termet specifike të gabuara

Qorr
Gaman

Shurdh-memec
Shurdhan

Shkurtabiq
Xhuxh

Termet specifike të duhura

**Person me aftësi të
kufizuara fizike**

**Person me sindromë
Down**

Person me Autizëm
Person me aftësi të kufizuar intelektuale
Person me aftësi të kufizuar psikosociale

Termet specifike të gabuara
I/E paralizuar / paralizik Sakat Hendikep Invalid Gungaç Gjytyrym Tapall
Mongoloid Me ngecje mendore
Person me sëmundjen e Autizmit Person i pazhvilluar mentalisht
I/E çmendur I/E vonshëm/vonshme Budalla Idiot Retard Me ngecje mendore
Skizofren Psikopat I/E çmendur